



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2025

Prishtinë, 12.01.2026: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka filluar të publikojë Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në shtator të vitit 2002 deri në muajin dhjetor 2015, ndërsa nga muaji janar 2016 është harmonizuar sipas konceptit ndërkombëtar dhe publikohet si Indeks i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Çmimet e konsumit kanë filluar të mblidhen në muajin maj të vitit 2002 i cili konsiderohet muaji bazë. Nga muaj janar i vitit 2016 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) bazuar në rekomandimet e Eurostat-it publikohet me vitin bazë 2015=100 dhe janë rillogaritur mbi këtë bazë të gjitha seritë kohore të Indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) përkatësisht Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) në vend dhe janë të publikuara në Ueb-faqen e ASK-ës (në publikimin vjetor të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit 2002 - 2024). Çmimet konsumit mblidhen prej datës 10 deri 20 të muajit në 14 Komuna të Kosovës. ASK nga muaji shtator i vitit 2002 në vazhdimësi ka publikuar në baza mujore IÇK - IHÇK dhe njëzetë e dy publikime në baza vjetore (2002 - 2024).

Ky publikim përmban tabelën me Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në Kosovë në baza mujore Janar 2010 – Dhjetor 2025, mesatarja vjetore 2010-2025 (2015=100), me ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje, paraqitja grafike, tabela për peshat specifike, indeksin për muajin Dhjetor 2025, ndryshimet mujore dhe vjetore të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit në përqindje (Dhjetor 2025 / Nëntor 2025) dhe (Dhjetor 2025 / Dhjetor 2024) për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it, tabelën me çmime mesatare për disa artikuj të konsumit dhe metodologjinë e llogaritjes së indekseve të harmonizuara të çmimeve të konsumit.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund ti dërgoni në adresën e ueb infoask@rks-gov.net

Ky publikim është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha	- Drejtor i Departamentit
Arlinda Mataj	- Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave të Çmimeve
Saranda Berisha Podvorica	- Zyrtare për Statistika të Çmimeve
Gëzim Ahmeti	- Zyrtar për Statistika të Çmimeve
Edina Zymeri	- Zyrtare për Statistika të Çmimeve

Janar, 2026

Drejtor Ekzekutiv i ASK-ës
Avni Kastrati

Për t'u konsultuar me publikime të tjera, vizitoni faqen e ASK: <http://ask.rks-gov.net>

Simbolet dhe Shkurtesat

IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
COICOP	Klasifikimi i konsumit individual sipas qëllimit
ABF	Anketa e buxhetit familjar
LLK	Llogaritë Kombëtare
IHÇK	Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
:	Shifra nuk është disponibël
0	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
-	Nuk aplikohet
%	Përqindje
‰	Promil
W	Ponderët statistikor (pesha specifike – IÇK/IHÇK)
Ø	Mesatare

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për muajin Dhjetor 2025

Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte (0,7%) në muajin Dhjetor 2025. Norma vjetore e inflacionit e matur në muajin Dhjetor 2025 me muajin Dhjetor 2024 ishte (5,3%).

Dhjetor 2025 / Nëntor 2025 0,7 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,7 % në muajin Dhjetor 2025 krahasuar me muajin Nëntor 2025. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: energjia elektrike (8,7%), biletat e fluturimeve (8,4%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (3,0%), perimet (2,9%), biletat e transportit rrugor (2,2%), veshje (1,2%), mishi (1,1%), qumështi, djathi dhe vezët (0,7%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (0,5%), mobilje dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dyshemeje (0,4%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,8 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-1.3%) me një ndikim prej -0,1 për qind në IHÇK-it.

Dhjetor 2025 / Dhjetor 2024 5,3 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 5,3 % në muajin Dhjetor 2025 krahasuar me muajin Dhjetor 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pemët (19,0%), energjia elektrike (18,3%), shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (18,1%), mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve personale të transportit (14,7%), mishi (14,4%), pushime të organizuara (13,5%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (13,1%), kafja, çaji dhe kakao (11,9%), qumështi, djathi dhe vezët (9,8%), shërbimet ambulatore (8,9%), shërbimet hoteliere (8,8%), duhani (6,6%), kujdesi personal (5,6%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (5,4%), pijet alkoolike (5,4%), buka dhe drithërat (5,3%), veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht (5,1%), prodhimet ushqimore (4,9%), mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit (4,8%), sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat (4,5%), gjërat personale (4,1%), arsimit (3,8%), veshje (3,7%), biletat e transportit rrugor (3,7%), perimet (3,6%), furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin (3,5%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (3,0%), gazetatat, librat dhe materialet për zyra (2,9%) dhe mobilje dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dyshemeje (2,5%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 5,4 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-1.7%) me një ndikim prej -0,1 për qind në IHÇK-it.

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për vitin 2025 3,9%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit në vend në vitin 2025 ishte më i lartë në një mesatare prej 3,9 % krahasuar me vitin 2024. Ngritja e indeksit të çmimeve të konsumit është vërejtur te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: kafja, çaji dhe kakao (15,2%), shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (11,6%), pemët (11,5%), energjia elektrike (11,4%), mish (11,0%), pushime të organizuara (10,3%), mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve personale të transportit (9,2%), vajrat dhe yndyrnat (8,4%), qumështi, djathi dhe vezët (7,2%), shërbimet hoteliere (7,0%), shërbimet ambulatore (6,3%), perimet (5,9%), pijet alkoolike (5,3%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (5,2%), gazetat, librat dhe materialet për zyra (5,1%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (4,8%), pajisjet terapeutike (4,7%), kujdesi personal (4,6%), veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht (4,0%), duhani (3,9%), buka dhe drithërat (3,8%), prodhimet ushqimore (3,6%), shërbimet financiare (3,4%), furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin (3,2%), këpucë (3,0%), sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat (3,0%), veshje (2,6%), gjërat personale (2,6%), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (1,8%), biletat e transportit rrugor (1,8%), mobilje dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dysHEMEJE (1,5%) dhe ndryshimet e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të disa nëngrupeve me një ndikim të vogël në IHÇK me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 4,1 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-4.6%), me një ndikim prej -0,3 për qind në IHÇK-it.

Tab. 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 –Dhjetor 2025 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje

Muaji\Viti	Indeksi (2015 = 100)	Inflacioni mujor %	Inflacioni vjetor %
Janar	88.0	0.6	0.7
Shkurt	88.2	0.2	1.1
Mars	88.1	-0.1	0.8
Prill	87.2	-1.0	1.6
Maj	87.5	0.3	2.2
Qershor	87.6	0.1	2.2
Korrik	87.9	0.3	2.7
Gusht	90.5	3.0	6.0
Shtator	90.8	0.3	6.0
Tetor	91.9	1.2	6.0
Nëntor	92.3	0.4	6.2
Dhjetor	93.2	1.0	6.5
Mesatarja vjetore 2010	89.4	:	3.5
Janar	94.5	1.4	7.4
Shkurt	96.5	2.1	9.4
Mars	97.6	1.1	10.8
Prill	96.5	-1.1	10.7
Maj	96.5	0.0	10.3
Qershor	95.7	-0.8	9.2
Korrik	95.2	-0.5	8.3
Gusht	95.3	0.1	5.3
Shtator	95.1	-0.2	4.7
Tetor	96.2	1.2	4.7
Nëntor	96.2	0.0	4.2
Dhjetor	96.5	0.3	3.5
Mesatarja vjetore 2011	96.0	:	7.4
Janar	97.3	0.8	3.0
Shkurt	98.2	0.9	1.8
Mars	98.3	0.1	0.7
Prill	97.6	-0.7	1.1
Maj	97.6	0.0	1.1
Qershor	97.3	-0.3	1.7
Korrik	97.3	0.0	2.2
Gusht	98.3	1.0	3.1
Shtator	99.1	0.8	4.2
Tetor	99.9	0.8	3.8
Nëntor	99.5	-0.4	3.4
Dhjetor	100.1	0.6	3.7
Mesatarja vjetore 2012	98.4	:	2.5
Janar	100.7	0.6	3.5
Shkurt	100.8	0.1	2.6
Mars	100.8	0.0	2.5
Prill	100.0	-0.8	2.5
Maj	99.7	-0.3	2.2
Qershor	99.9	0.2	2.7
Korrik	99.6	-0.3	2.4
Gusht	99.5	-0.1	1.2
Shtator	99.3	-0.2	0.2
Tetor	100.1	0.8	0.2
Nëntor	100.3	0.2	0.8
Dhjetor	100.6	0.3	0.5
Mesatarja vjetore 2013	100.1	:	1.7

Tab. 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Dhjetor 2025 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje (vazhdim)

Muaji\Viti	Indeksi (2015 = 100)	Inflacioni mujor %	Inflacioni vjetor %
Janar	100.9	0.3	0.2
Shkurt	100.9	0.0	0.1
Mars	101.1	0.2	0.3
Prill	100.3	-0.8	0.3
Maj	100.2	-0.1	0.5
Qershor	100.3	0.1	0.4
Korrik	100.4	0.1	0.8
Gusht	100.4	0.0	0.9
Shtator	100.6	0.2	1.3
Tetor	100.7	0.1	0.6
Nëntor	100.4	-0.3	0.1
Dhjetor	100.2	-0.2	-0.4
Mesatarja vjetore 2014	100.5	:	0.4
Janar	100.3	0.1	-0.6
Shkurt	100.6	0.3	-0.3
Mars	100.7	0.1	-0.4
Prill	99.9	-0.8	-0.4
Maj	99.7	-0.1	-0.5
Qershor	99.9	0.1	-0.4
Korrik	99.6	-0.2	-0.8
Gusht	99.7	0.1	-0.7
Shtator	99.4	-0.3	-1.2
Tetor	100.0	0.6	-0.7
Nëntor	100.1	0.1	-0.3
Dhjetor	100.0	0.0	-0.2
Mesatarja vjetore 2015	100.0	:	-0.5
Janar	100.5	0.4	0.1
Shkurt	100.7	0.2	0.0
Mars	100.8	0.1	0.1
Prill	99.8	-1.0	-0.1
Maj	99.6	-0.2	-0.1
Qershor	99.6	-0.1	-0.3
Korrik	99.6	0.0	0.0
Gusht	99.8	0.2	0.0
Shtator	99.9	0.2	0.6
Tetor	100.9	0.9	0.9
Nëntor	101.0	0.1	0.9
Dhjetor	101.3	0.4	1.3
Mesatarja vjetore 2016	100.3	:	0.3
Janar	102.2	0.8	1.7
Shkurt	102.3	0.2	1.7
Mars	102.3	-0.1	1.5
Prill	102.0	-0.3	2.2
Maj	101.2	-0.8	1.5
Qershor	101.5	0.3	1.9
Korrik	101.3	-0.2	1.7
Gusht	101.5	0.2	1.7
Shtator	101.6	0.1	1.7
Tetor	101.8	0.2	0.9
Nëntor	101.8	0.1	0.9
Dhjetor	101.8	0.0	0.5
Mesatarja vjetore 2017	101.8	:	1.5

Tab. 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Dhjetor 2025 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje (vazhdim)

Muaji\Viti	Indeksi (2015 = 100)	Inflacioni mujor %	Inflacioni vjetor %
Janar	102.0	0.2	-0.2
Shkurt	102.3	0.3	0.0
Mars	102.4	0.1	0.1
Prill	102.4	0.0	0.4
Maj	102.2	-0.2	1.0
Qershor	102.3	0.1	0.8
Korrik	102.5	0.2	1.2
Gusht	103.0	0.4	1.5
Shtator	103.1	0.1	1.4
Tetor	103.3	0.2	1.5
Nëntor	103.9	0.7	2.1
Dhjetor	104.8	0.8	2.9
Mesatarja vjetore 2018	102.8	:	1.1
Janar	105.2	0.4	3.1
Shkurt	105.6	0.4	3.2
Mars	105.7	0.1	3.3
Prill	105.9	0.1	3.4
Maj	105.7	-0.2	3.4
Qershor	105.3	-0.3	3.0
Korrik	105.2	-0.1	2.6
Gusht	105.7	0.5	2.7
Shtator	105.6	-0.1	2.4
Tetor	105.5	0.0	2.2
Nëntor	105.7	0.2	1.7
Dhjetor	106.0	0.2	1.2
Mesatarja vjetore 2019	105.6	:	2.7
Janar	106.8	0.8	1.5
Shkurt	106.6	-0.2	1.0
Mars	106.5	-0.1	0.7
Prill	106.2	-0.3	0.3
Maj	105.9	-0.3	0.2
Qershor	105.4	-0.4	0.1
Korrik	105.1	-0.3	-0.1
Gusht	105.2	0.1	-0.5
Shtator	105.1	-0.1	-0.4
Tetor	105.3	0.2	-0.2
Nëntor	105.4	0.1	-0.3
Dhjetor	106.1	0.6	0.1
Mesatarja vjetore 2020	105.8	:	0.2
Janar	106.6	0.5	-0.2
Shkurt	107.4	0.7	0.7
Mars	107.8	0.4	1.2
Prill	108.2	0.3	1.9
Maj	107.9	-0.2	2.0
Qershor	107.9	0.0	2.4
Korrik	108.8	0.8	3.5
Gusht	110.1	1.2	4.7
Shtator	110.2	0.1	4.9
Tetor	111.3	1.0	5.7
Nëntor	112.7	1.2	6.9
Dhjetor	113.2	0.5	6.7
Mesatarja vjetore 2021	109.3	:	3.4

Tab. 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Dhjetor 2025 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje (vazhdim)

Muaji\Viti	Indeksi (2015 = 100)	Inflacioni mujor %	Inflacioni vjetor %
Janar	114.2	0.9	7.1
Shkurt	115.5	1.1	7.5
Mars	118.6	2.7	10.0
Prill	120.3	1.5	11.2
Maj	121.4	0.9	12.5
Qershor	123.1	1.4	14.1
Korrik	124.2	0.9	14.2
Gusht	124.5	0.2	13.0
Shtator	124.2	-0.2	12.7
Tetor	125.4	0.9	12.7
Nëntor	125.8	0.3	11.6
Dhjetor	126.9	0.9	12.1
Mesatarja vjetore 2022	122.0	:	11.6
Janar	127.9	0.8	12.0
Shkurt	127.6	-0.3	10.5
Mars	127.0	-0.4	7.1
Prill	127.0	0.0	5.6
Maj	126.6	-0.3	4.3
Qershor	126.6	0.0	2.8
Korrik	127.1	0.4	2.3
Gusht	128.4	1.0	3.2
Shtator	129.5	0.9	4.2
Tetor	129.5	0.0	3.3
Nëntor	129.4	-0.1	2.9
Dhjetor	129.8	0.3	2.3
Mesatarja vjetore 2023	128.0	:	4.9
Janar	130.2	0.3	1.8
Shkurt	130.4	0.1	2.2
Mars	130.0	-0.3	2.3
Prill	130.1	0.1	2.4
Maj	129.6	-0.4	2.4
Qershor	129.6	0.0	2.4
Korrik	129.9	0.3	2.2
Gusht	130.2	0.2	1.4
Shtator	129.8	-0.3	0.2
Tetor	130.0	0.2	0.4
Nëntor	130.3	0.2	0.7
Dhjetor	131.2	0.7	1.1
Mesatarja vjetore 2024	130.1	:	1.6
Janar	132.2	0.7	1.5
Shkurt	132.6	0.4	1.7
Mars	133.7	0.8	2.9
Prill	134.0	0.2	3.0
Maj	134.3	0.3	3.6
Qershor	135.2	0.7	4.3
Korrik	135.5	0.2	4.3
Gusht	136.2	0.5	4.5
Shtator	135.8	-0.2	4.7
Tetor	136.7	0.6	5.1
Nëntor	137.2	0.4	5.3
Dhjetor	138.2	0.7	5.3
Mesatarja vjetore 2025	135.1	:	3.9

Fig. 1: Indeksi i harmonizuar vjetor i çmimeve të konsumit sipas viteve 2010 - 2025 (2015=100)





Fig. 2: Normat vjetore dhe mujore të inflacionit në përqindje të matura nga IHÇK-it



Tab. 2: Peshat, IHÇK-it për muajin Dhjetor 2025 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2025 në %	XII - 2025 2015=100	XII- 2025 XI- 2025	XII- 2025 XII - 2024	Indeksi mesatar vjetor 2025 2015=100	2025 2024
00	Gjithsej IHÇK	1000.0	138.2	0.7	5.3	135.1	3.9
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	321.1	161.0	0.6	8.6	156.3	7.6
01.1	Ushqimi	251.3	163.8	0.8	9.4	158.6	7.6
01.1.1	Buka dhe drithërat	60.2	176.7	0.1	5.3	173.3	3.8
01.1.2	Mishi	66.5	168.5	1.1	14.4	160.5	11.0
01.1.3	Peshqit	3.0	145.8	0.2	5.5	142.0	4.3
01.1.4	Qumështi, djathi dhe vezët	49.5	167.9	0.7	9.8	158.2	7.2
01.1.5	Vajrat dhe yndyrnat	6.5	198.3	0.0	4.1	195.4	8.4
01.1.6	Pemët	19.5	113.2	-0.1	19.0	113.8	11.5
01.1.7	Perimet	29.2	144.0	2.9	3.6	142.3	5.9
01.1.8	Sheqeri, reçeli, mjalta, çokolata dhe ëmbëlsirat	11.1	163.7	0.1	4.5	159.6	3.0
01.1.9	Prodhimet ushqimore	6.0	147.9	0.2	4.9	144.4	3.6
01.2	Pijet joalkoolike	69.8	147.2	0.0	5.7	144.5	8.0
01.2.1	Kafja, çaji dhe kakao	21.7	200.0	0.2	11.9	193.8	15.2
01.2.2	Uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet	48.1	133.0	-0.1	3.0	131.4	4.8
02	Pijet alkoolike, duhani	62.2	150.5	0.1	6.2	146.9	4.4
02.1	Pijet alkoolike	20.2	147.7	-0.3	5.4	145.0	5.3
02.2	Duhani	42.0	155.4	0.3	6.6	151.2	3.9
03	Veshje dhe këpucë	44.2	113.7	1.0	3.5	111.7	2.7
03.1	Veshje	34.8	113.8	1.2	3.7	111.5	2.6
03.2	Këpucë	9.4	111.9	0.4	2.5	111.4	3.0
04	Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	89.9	138.5	3.7	10.7	128.6	4.1
04.1	Pagesa aktuale për banim	4.0	101.7	0.0	1.2	101.3	1.0
04.3	Mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit	9.4	138.6	0.0	4.8	136.5	3.4
04.4	Furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin	11.7	106.7	0.0	3.5	106.3	3.2
04.5	Energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera	64.8	146.8	5.0	13.4	133.1	4.6
04.5.1	Energjia elektrike	26.7	137.6	8.7	18.3	119.9	11.4
04.5.2	Gaz	5.0	133.7	0.0	-1.8	135.2	-0.6
04.5.4	Lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj.	29.6	194.8	3.0	13.1	178.3	-1.3
04.5.5	Energjia termike	3.5	88.4	0.0	0.0	88.4	0.0
05	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	72.8	126.9	0.0	2.4	125.8	2.7
05.1	Mobilje dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dysHEMEJE	12.0	117.3	0.4	2.5	115.4	1.5
05.2	Tekstile shtëpiake	1.2	111.3	0.4	2.8	110.6	2.3
05.3	Pajisje shtëpiake	17.1	114.0	-0.9	-1.0	114.7	1.1
05.4	Qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës	13.9	121.9	-0.1	0.5	121.9	1.8
05.5	Veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht	13.8	131.2	0.0	5.1	128.9	4.0
05.6	Mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake	14.8	153.7	0.5	5.4	150.6	5.2

Tab. 2: Peshat, IHÇK-it për muajin Dhjetor 2025 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it (vazhdim)

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2025 në %	XII - 2025 2015=100	XII- 2025 XI- 2025	XII- 2025 XII - 2024	Indeksi mesatar vjetor 2025 2015=100	2025 2024
06	Shëndetësia	25.7	124.5	0.0	6.3	121.9	4.8
06.1	Produkte mjekësore, aparaturë dhe pajisje	7.6	124.1	0.0	3.2	121.6	3.2
06.1.1	Produktet farmaceutike	2.5	122.4	0.0	2.8	120.9	2.5
06.1.2	Produkte të tjera mjekësore	1.3	111.0	0.0	0.6	110.4	0.6
06.1.3	Pajisjet terapeutike	3.7	128.1	0.0	4.3	124.1	4.7
06.2	Shërbimet ambulatore	15.7	126.3	0.0	8.9	123.2	6.3
06.3	Shërbimet spitalore	2.4	103.6	0.0	0.0	103.6	0.0
07	Transporti	183.6	118.9	0.4	0.3	118.7	-1.4
07.1	Blerja e automjeteve	56.1	108.4	0.0	-0.7	107.9	-1.6
07.2	Përdorimi i pajisjeve për transportin personal	88.7	119.3	-1.0	0.4	119.8	-2.3
07.2.1	Pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal	8.6	115.8	0.0	2.0	115.2	2.3
07.2.2	Karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal	71.7	115.3	-1.3	-1.7	117.2	-4.6
07.2.3	Mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve personale të transportit	3.6	160.8	0.4	14.7	150.5	9.2
07.2.4	Shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit	4.9	170.9	0.0	18.1	157.8	11.6
07.3	Shërbimet për transport	38.8	141.5	4.6	1.6	140.2	1.6
08	Mjetet e komunikimit	31.9	112.0	0.0	-0.3	112.1	-1.4
08.1	Shërbimet postare	2.3	104.6	0.0	0.0	104.6	0.0
08.2	Pajisjet telefonike dhe të telefaksit	1.9	65.8	-0.2	-5.8	67.5	-3.7
08.3	Shërbimet telefonike dhe të telefaksit	27.7	119.7	0.0	0.0	119.7	-1.4
09	Rekracioni dhe kultura	58.3	108.6	0.1	1.0	108.8	1.8
09.1	Pajisjet audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informatave	12.2	84.8	0.4	-2.2	85.2	-1.1
09.2	Pajisjet tjera të qëndrueshme për rekreacion dhe kulturë	0.7	108.8	0.0	-0.3	109.0	0.5
09.3	Gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret	26.5	118.8	-0.1	-0.7	119.6	0.3
09.4	Shërbimet rekreative dhe kulturore	4.1	115.0	0.3	1.6	113.5	0.5
09.5	Gazetat, librat dhe materialet për zyra	10.0	117.4	0.0	2.9	116.9	5.1
09.6	Pushime të organizuara	4.8	137.6	0.0	13.5	136.4	10.3
10	Arsimi	8.8	108.1	0.0	3.8	107.6	3.3
11	Restorantet dhe hotelet	41.0	142.7	0.2	8.5	139.1	6.8
11.1	Shërbimet hoteliere	39.7	144.9	0.2	8.8	141.2	7.0
11.2	Shërbimet për strehim	1.4	115.1	0.0	0.6	114.9	0.6
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	60.5	125.5	0.2	3.4	123.7	3.2
12.1	Kujdesi personal	26.0	133.4	0.3	5.6	130.5	4.6
12.3	Gjërat personale	12.1	124.1	0.4	4.1	121.8	2.6
12.4	Mbrojtja sociale	0.4	124.9	0.0	1.1	124.0	0.4
12.5	Sigurimet	6.0	122.9	0.0	1.3	122.6	1.1
12.6	Shërbimet financiare	13.1	119.0	0.0	0.0	119.0	3.4
12.7	Shërbimet tjera	2.8	100.8	0.0	0.0	100.8	0.4

Tab. 3: Çmimi mesatar në euro për disa artikuj dhe shërbime të konsumit

Kodi	Artikujt	Njësia matëse	XII 2024	XI 2025	XII 2025
101	Oriz	1 kg	1.67	1.78	1.78
102	Miell gruri	1 kg	0.81	0.84	0.84
103	Bukë e bardhë	500 gr	0.51	0.55	0.55
111	Mish gjedhi pa eshtra	1 kg	9.02	11.02	11.21
112	Mish viçi	1 kg	10.22	12.01	12.27
114	Mish pule	1 kg	4.11	4.59	4.65
131	Qumësht (Tetrapak)	1 lit	1.23	1.25	1.25
133	Jogurt	1 lit	1.20	1.28	1.29
137	Vezë	30 copë	3.30	4.68	4.86
141	Vaj ushqimor luledielli	1 lit	1.52	1.67	1.67
151	Mollë	1 kg	0.91	1.17	1.21
152	Dardhë	1 kg	1.88	2.34	2.24
153	Banane	1 kg	1.38	1.51	1.47
155	Limon	1 kg	1.50	2.30	2.25
161	Patate	1 kg	0.60	0.67	0.70
162	Domate	1 kg	1.85	1.15	1.39
163	Fasule	1 kg	3.68	3.76	3.80
167	Specatë pa djegës	1 kg	2.14	1.74	1.76
175	Sheqer	1 kg	1.21	1.18	1.15
192	Kafe e bluar	1 kg	13.94	15.78	15.82
193	Çaj	1 kg	9.29	9.25	9.31
195/1	Uji natyral pa gaz	1.5 lit	0.37	0.39	0.39
196	Coca cola	2 lit	1.58	1.59	1.58
197	Lëng pemësh	1 lit	1.08	1.14	1.14
204	Birrë	0.5 lit	0.86	0.89	0.89
217	Cigare	1 pako	3.10	3.26	3.27
416	Energja elektrike (Pa kosto fikse)	1 kwh	0.07	0.08	0.09
418	Dru zjarri	1 m ³	55.91	61.00	63.23
701	Benzin	1 lit	1.26	1.23	1.20
702	Dizel	1 lit	1.23	1.23	1.21

Shpjegime metodologjike

Përkufizime

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) i Kosovës, i prodhuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), është i përpiluar sipas metodave të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Eurostat e ka definuar IHÇK si standard Evropian për indeksin e çmimeve të konsumit. Indeksi i kalkuluar dhe rezultatet e tyre prezantohen përmes Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP), klasifikim ky ndërkombëtarë i cili klasifikon konsumin në Divizione, Grupe dhe Klasa artikujsh. Sipas COICOP-it, ASK ka ndarë 91 klasa konsumi të definuar (në nivel 4-shifror) më tutje në 420 produkte (agregat elementarë). ASK ka përcaktuar peshë për çdo element agregues dhe çdo muaj grumbullon çmime për secilin agregat elementarë.

Çdo muaj IHÇK kalkulohet në dy hapa:

1. Indekset elementarë (treguesit për agregat elementarë) llogariten nga çmimet e grumbulluara duke përdorur formulën e mesatares gjeometrike të papeshuar (të Jevon-it).
2. Indekset e nivelit më të lartë, duke përfshirë vetë IHÇK, llogariten duke nxjerrë mesataren e indekseve elementarë përmes formulës së mesatares aritmetike të peshuar (tipi i Laspeyres).

Peshat elementare të agreguara janë bazuar në vlerësimet e shpenzimeve të konsumit vjetor. ASK për 91 klasa konsumi bën vlerësimin e shpenzimeve të konsumit vjetor nga Anketa e Buxhetit Familjar (ABF) dhe Llogaritë Kombëtare (LLK), peshat brenda klasave të konsumit vijnë nga burimet e brendshme të ASK-së. Peshat specifike nga janari 2013, ishin të bazuara në vlerësimet e të dhënave të Anketës së Buxhetit Familjar dhe Llogarive Kombëtare që i referohen vitit 2012. Nga janari i vitit 2015 peshat specifike të rifreskuara bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar të vitit 2013. Nga janari i vitit 2016 peshat specifike për artikuj dhe shërbime të harmonizuara sipas E-coicop (rekomandime nga Eurostat) bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar të vitit 2014. Nga janari i vitit 2017, peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2015. Nga janari i vitit 2018 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2016. Nga janari i vitit 2019, peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2017. Nga janari i vitit 2020, peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2018. Nga janari i vitit 2021, peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2019. Rifreskimi i peshave çdo vit, siguron se IHÇK reflekton trendet aktuale të konsumit.

Të gjitha blerjet monetare të bëra në vend (brenda vendit) nga sektori i ekonomive familjare definojnë si gjithsej shpenzimet e konsumit vjetor. Ky definicion përputhet me kategorinë e LLK të quajtur Konsumi Final Monetar i Ekonomive Familjare (HFMC) dhe nënkupton se peshat duhet të përfshijnë vlerën e konsumit të produkteve vetanake dhe koston e banimit nga vetë pronari.

Deri në dhjetorin e vitit 2014 peshat kanë përfshi shpenzimet vetëm për konsumatorët rezident, ndërsa nga janari i vitit 2015 përfshihen edhe shpenzimet për konsumatorët jo rezident.

Për të vlerësuar ndryshimet mujore të çmimeve, stafi i ASK mbledh çmime për një numër të artikujve specifik (shpesh të quajtur shporta e tregut) të zgjedhura si përfaqësim i agregateve elementar. Qëllimi është që të mblidhen të gjitha çmimet, pikërisht artikujve të njëjtë për çdo muaj, kurdo që një çmim nuk ka mundësi të mblidhet, atëherë procedurat e llogaritjes duhet të aplikohen me kujdes për t'u shmangur rezultatit të anueshëm.

Grumbulluesit e të dhënave pranë ASK-së, me seli në shtatë qendra rajonale (zyre rajonale statistikore), mbledhin përafërsisht mbi 6800 çmime gjatë periudhës nga data 10-20 të çdo muaji referues. Çmimet

mbledhjen në supermarkete, ndërmarrje shërbyese, dyqane, tregje dhe pika tjera të shitjes me pakicë në katërbëdhjetë komuna të Kosovës:

- Gjakovë
- Gjilan
- Istog
- Kaçanik
- Kamenicë
- Mitrovicë
- Rahovec
- Pejë
- Podujevë
- Prishtinë
- Prizren
- Suharekë
- Ferizaj
- Vushtrri

Stafi i zyrës qendrore të ASK-së në Prishtinë mbledh çmimet për artikuj dhe shërbime si rryma, uji, shërbimet postare dhe telekomunikacioni, për transportin ajror dhe hekurudhor .

Indekset Elementar

Indeksi elementar për një muaj është i barabartë me indeksin e tij në muajin paraprak, të shumëzuar me ndryshimin e çmimit të matur për një muaj, i llogaritur nga çmimet e grumbulluara. ASK përdor formulën e mesatares gjeometrike (apo të Jevon-it) për të llogaritur ndryshimet njëmuajore: shkalla e mesatares gjeometrike të muajit aktual në mesataren gjeometrike të çmimeve të mbledhura për muajin e kaluar.

Indeksi i agregatit elementar e për muajin m

- = Indeksi i çmimit për agregatin elementar e për muajin m
- = Indeksi i çmimit për agregatin elementar e për muajin m-1
- = Çmimi për artikullin i në muajin m
- = Çmimi për artikullin i në muajin m-1
- = Numri i çmimeve të mbledhura për agregatin elementar

Indekset e Nivelit më të Lartë

Në Kosovë, Indekset e IHÇK së pari llogariten në grupe (të agregateve elementare) dhe pastaj këto kombinohen për të nxjerrë IHÇK e tërësishëm.

Indekset e Nivelit të Lartë peshohen me mesataret aritmetike të indekseve elementare. Në IÇK është përdorur formula e Young-ut deri në dhjetor 2013, peshat janë pjesë e peshimit të parregulluar për shpenzime në periudhë. Që nga janari 2014 është kaluar në përdorimin e formulës së Lowe-it për kalkulimin e indeksit, me pesha të cilat janë pjesë e peshave të periudhave të shpenzimeve, e të cilat janë të azhurnuara me ndryshimet e çmimeve. (Formula e Lowe-it është e përafërt me formulat aktuale të Laspeyres).

Të dy formulat, si formula e Young-ut dhe ajo e Lowe-it janë mesatare aritmetike të peshuara me pesha që janë pjesë e shpenzimeve të konsumit, dhe të dyja janë lloj i formulave të indeksit të Laspeyres. Aktualisht IHÇK përdor formulën e Lowe-it për indekse, peshat e të cilit janë pjesë e shpenzimeve gjatë periudhës së peshuar viti 2010. Peshat e reja nga të dhënat e LLK dhe ABF- vitit 2012 janë aplikuar nga janari i vitit 2014. IÇK ka kaluar në kalkulimin e indekseve me formulën Lowe-it; (peshat kanë qenë pjesë e shpenzimeve të vitit 2012 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2013. Nga janari i vitit 2015 janë aplikuar peshat specike nga të dhënat e LLK dhe ABF të vitit 2013 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2014. Nga janari i vitit 2016 peshat specifike bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar (ABF) të vitit 2014 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetorit të vitit 2015. Nga janari i vitit 2017 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2015 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetorit të vitit 2016. Nga janari i vitit 2018 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2016 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetorit të vitit 2017. Nga janari i vitit 2019 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2017 të kalkuluara

me ndryshimet e çmimeve të dhjetorit të vitit 2018. Nga janari i vitit 2020 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2018 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetorit të vitit 2019.

Peshat e Indeksit

Formula e Young Peshon Agregatet Elementare brenda Grupeve

$$w_{e,g}^b = \frac{x_e^b}{\sum_{e=1}^{k_g} x_e^b} \quad \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g} = 1$$

$w_{e,g}^b$ = Pesha për agregat elementarë **e** brenda grupit **g** në periudhën peshuese **b**

x_e^b = shpenzimet për agregatin elementar **e** në periudhën peshuese **b** (Aktualisht **b** = 2012)

k_g = Numri i agregateve elementare në grupin **g**

Formula e Young peshon grupet brenda IHÇK së tërësishëm

$$w_g^b = \frac{\sum_{e=1}^{k_g} x_e^b}{\sum_{g=1}^h \sum_{e=1}^{k_g} x_e^b} \quad \sum_{g=1}^h w_g^b = 1$$

w_g^b = Pesha për grupin **g** në periudhën peshuese **b**

h = Numri i grupeve në ICK

Formula e Lowe-it peshon agregatet elementarë brenda grupeve

$$w_{e,g}^b = \frac{x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v}}{\sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})} \quad \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g} = 1$$

$w_{e,g}^b$ = Pesha për agregat elementar **e** brenda grupit **g** në periudhën peshuese **b**
(Në përdorim nga Janari 2014, **b** = 2012)

$a_e^{b \rightarrow v}$ = faktor rregullues i peshave për agregatet elementar **e**

$$a_e^{b \rightarrow v} = I_e^v / \frac{1}{12} \left(\sum_{m=Jan}^{Dec} I_e^{m/b} \right)$$

I_e^v = Indeksi i çmimit për agregate elementar **e** për muajin **v**
(Në përdorim nga Janari 2014, **v** = Dhjetor 2013)

$I_e^{m/b}$ = Indeksi i çmimeve për agregat elementarë **e** në muajin **m** në vitin **b**

Formula e Lowe peshon grupet brenda IHÇK së tërësishëm

$$w_g^b = \frac{\sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})}{\sum_{g=1}^h \sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})} \quad \sum_{g=1}^h w_{e,g} = 1$$

Indekset për Grupet e niveleve më të larta

$$I_g^m = \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g}^b * I_e^m \quad I_e^0 = 100$$

Për shumicën e artikujve periodha **0** është Maj 2002 , por kjo periudhë ndryshon për sipas inkuadrimin të artikujve të përfshirë më vonë

IHÇK i tërësishëm

IHÇK i tërësishëm është një mesatare aritmetike e peshuar e indekseve të grupeve. Në IHÇK është përdor formula e *Young-it*, por që nga Janari i vitit 2014 është kaluar në përdorimin e formulës së Lowe-it.

Për shkak se nëngrupet kanë baza të ndryshme indeksesh (shumica kanë për bazë Maj 2002=100, por grupet e shtuara më vonë kanë bazë tjetër, nga janari i vitit 2016 idenkset janë të kalkuluar me vitin bazë 2015=100), indekset e grupeve duhet të ribazohen në një periudhë të përbashkët, që është muaji **v** (muaji paraprak para së të vihen në përdorim peshat e reja).

$$HICP^m = HICP^v \times \sum_{\varepsilon=1}^h w_{\varepsilon}^b \times \frac{I_{\varepsilon}^m}{I_{\varepsilon}^v} \quad HICP^0 = 100$$

$HICP^m$ = Indeksi i harmonizuar i çmimit të konsumit për muajin **m**

v = muaji paraprak para së të përdoren peshat e reja (Aktualisht **v** = Dhjetor 2020)

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.